

nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 287 të K.Penal. Lidhur me këtë procedim nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është disponuar në datë 18/1/2016 në përputhje me përcaktimet e nenit 328 të K.Pr.Penale dhe akti i marrë i është njoftuar si kallëzuesit ashtu dhe shtetasit Petrit Aliaj.

Gjithashtu ne rastin e shtetasit Gjin Gjoni, mbi bazën e kallëzimit të I.L.D.K.P.K.I, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka regjistruar në datë 02/05/2014 procedimin penal Nr. 1098 për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Refuzimit për deklaramin, mosdeklaramin, fshehjes ose deklaramit të rremë të pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, të parashikuara nga nenet 186 e 257/a të Kodit Penal. Me urdhrin e datës 12/05/2014, në kuadër të këtij procedimi penal u regjistruan në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime emrat e shtetasve Gjin Gjoni dhe Elona Çausi. Me vendimin e datës 20/04/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është disponuar për pushimin e ndjekjes penale në ngarkim të personave nën hetim Gjin Gjoni dhe Elona Çausi, bazuar në përcaktimet e nenit 328/1, gërma f, të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa çështja ka vazhduar të qëndrojë në hetim, pa autor, për shkak të nevojës së kryerjes së veprimeve të tjerë hetimorë që janë kërkuar të kryhen nëpërmjet kërkesave për ndihmë juridike derguar autoriteteve gjyqësore kompetente të shteteve të Gjermanisë dhe Francës. Deri në mbërritjen e akteve të kërkuar nëpërmjet letërporosive, hetimet në kuadër të këtij procedimi penal janë pezulluar dhe pas mbërritjes së tyre, u rifilluan (të dhënat e administruara nga Autoritetet Gjyqësore Gjermane nuk mund të jepen pasi përbëjnë prova thelbësore për vijueshmërinë e hetimeve duke përbërë sekret hetimor). Nga shqyrtimi i akteve të sjellë nga organet kompetente të drejtësisë së shtetit të Gjermanisë është konstatuar se ka pasur vend për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve lidhur me faktet e përmendura në kallëzimin penal dhe çështja penale i ka kaluar për kompetencë hetimi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Aktualisht, ky procedim penal nuk hetohet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, por në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

DREJTUES I PROKURORISË

DRITAN GINA

